



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-06

Prokurori kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep

Selimit, dhe Jakup Krasniqit

Vendosi: Trupi Gjykues II

Gjykatës Çarls L. Smith III, Kryegjykatës

Gjykatës Kristof Barte

Gjykatës Ginel Metro

Gjykatës Fergal Gejnor, gjykatës rezervë

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 17 maj 2023

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Vendim mbi Mocionin e Prokurorisë për Konstatim Gjyqësor të Fakteve të Shqyrtuara në Procese të Tjera me Shtojcën 1 (konfidenciale) dhe Shtojcën 2 (publike)

Ushtruesit të Detyrës së Prokurorit të Specializuar
Aleks Uajting

Mbrojtësit të Viktimave
Sajmon Loz

Mbrojtjes së Hashim Thaçit
Gregori Kihou

Mbrojtjes së Kadri Veselit
Ben Emerson

Mbrojtjes së Rexhep Selimit
Xhefri Roberts

Mbrojtjes së Jakup Krasniqit
Venkatesvari Alagenda

TRUPI GJYKUES II ("Trupi Gjykues"), në bazë të neneve 3(2)(d) dhe (3), 12, dhe 21 të Ligjit Nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji") dhe rregullave 95(5), 104(1)(b), 138, dhe 157(2) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës ("Rregullorja"), lëshon këtë vendim.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 18 janar 2023, në konferencën përgatitore për gjykimin, Trupi Gjykues urdhëroi: (i) Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("ZPS") dhe katër ekipet e Mbrojtjes (së bashku, "Mbrojtja") të dorëzonin mocione për konstatim gjyqësor të fakteve të shqyrtuara në procese të tjera deri më 1 mars 2023, në ora 16:00, dhe (ii) palët dhe pjesëmarrësit e tjerë të dorëzonin përgjigje dhe kundërpërgjigje përkatësisht deri më 3 prill 2023, në ora 16:00, dhe 10 prill 2023, në ora 16:00.¹
2. Më 1 mars 2023, ZPS-ja dorëzoi një mocion ("Mocioni i ZPS-së") për konstatim gjyqësor të fakteve të shqyrtuara në procese të tjera ("faktet e propozuara, të shqyrtuara në procese të tjera").²
3. Më 24 mars 2023, ZPS-ja dorëzoi versionin publik të fakteve të propozuara, të shqyrtuara në procese të tjera, dhe versionet e paredaktuara, të certifikuara, ose zyrtare të disa aktgjykimeve relevante për Mocionin e ZPS-së.³
4. Më 3 prill 2023, Mbrojtja iu përgjigj Mocionit të ZPS-së ("Përgjigjja e Përbashkët e Mbrojtjes").⁴
5. Më 11 prill 2023, ZPS-ja iu kundërpërgjigj Përgjigjes së Përbashkët të

¹ Transkripti i seancës, 18 janar 2023, f. 1903, rreshtat 5-13.

² F01330, Prokurori i Specializuar, *Mocion i Prokurorisë për Konstatim Gjyqësor të Fakteve të Shqyrtuara në Procese të Tjera*, 1 mars 2023, me Shtojcat 1 dhe 2, konfidenciale.

³ F01395, Prokurori i Specializuar, *Parashtrim i Prokurorisë i Versionit Publik të F01330/A01 dhe një Aspekti të Lidhur me Të*, 24 mars 2023, me Shtojcën 1, publike, dhe Shtojcën 2, konfidenciale.

⁴ F01417, Mbrojtësi i Specializuar, *Përgjigje e Përbashkët e Mbrojtjes ndaj Mocionit të Prokurorisë për Konstatim Gjyqësor të Fakteve të Shqyrtuara në Procese të Tjera*, 3 prill 2023, me Shtojcën 1, konfidenciale.

Mbrojtjes (“Kundërpërgjigja e ZPS-së”).⁵

6. Më 28 prill 2023, ZPS-ja dorëzoi një njoftim në lidhje me Mocionin e ZPS-së (“Njoftimi i ZPS-së”), me të cilin tërhoqi kërkesën për konstatim gjyqësor të disa fakteve të propozuara, të shqyrtuara në procese të tjera, dhe njoftoi Trupin Gjyqësor për disa gabime shtypi dhe për disa pasaktësi të paqëllimshme dhe mungesa në listën e vet të fakteve të propozuara, të shqyrtuara në procese të tjera.⁶

II. PARASHTRIMET

7. ZPS-ja kërkon që Trupi Gjyqësor të bëjë konstatim gjyqësor të fakteve relevante për këtë çështje të cilat janë shqyrtuar në gjykime para Tribunalit Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë (“TPNJ”) dhe gjykatave të Kosovës. Sipas ZPS-së, faktet e propozuara, të shqyrtuara në procese të tjera, përmbushin kriteret e rregullës 157 në kuptimin që ato fakte janë relevante, të qarta dhe jo të dykuptimshme. ZPS-ja gjithashtu parashtron se konstatimi gjyqësor i fakteve të propozuara, të shqyrtuara në procese të tjera, do të ndihmojë efikasitetin gjyqësor, është në interes të drejtësisë, dhe respekton të drejtat e të akuzuarve për gjykim të drejtë, publik dhe të shpejtë.⁷

8. Mbrojtja kundërshton “përpjekjen e ZPS-së për të kërkuar konstatim gjyqësor për një numër tejet të madh dhe me shtrirje të pashembullt të fakteve të shqyrtuara në procese të tjera” dhe kërkon që Trupi Gjyqësor të hedhë poshtë Mocionin e ZPS-së për pranimin e fakteve të propozuara, të shqyrtuara në procese të tjera, të kundërshtuara në Shtojcën 1 të Përgjigjes së Përbashkët të Mbrojtjes.⁸

⁵ F01443, Prokurori i Specializuar, *Kundërpërgjigje e Prokurorisë ndaj Përgjigjes së Përbashkët të Mbrojtjes ndaj Mocionit të Prokurorisë për Konstatim Gjyqësor të Fakteve të Shqyrtuara në Procese të Tjera*, 11 prill 2023, me Shtojcën 1, konfidenciale.

⁶ F01487, Prokurori i Specializuar, *Njoftim i Prokurorisë Lidhur me Parashtrimin e Protokolluar F01330*, 28 prill 2023, me Shtojcën 1, konfidenciale.

⁷ Mocioni i ZPS-së, para. 1, 18.

⁸ Përgjigja e Përbashkët e Mbrojtjes, para. 1, 38, që i referohet Shtojcës 1 të Përgjigjes së Përbashkët të Mbrojtjes.

9. ZPS-ja përgjigjet se faktet e propozuara, të shqyrtuara në procese të tjera, janë vërtetuar në bazë të provave në aktgjykime përfundimtare të mëparshme; ato përmbushin të gjitha kriteret, dhe rrjedhimisht janë të përshtatshme për konstatim gjyqësor.⁹ Rrjedhimisht, ZPS-ja parashtron se Trupi Gjykes duhet të hedhë poshtë kundërshtimet e Mbrojtjes dhe të bëjë konstatim gjyqësor të fakteve të propozuara, të shqyrtuara në procese të tjera.¹⁰

III. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

10. Rregulla 157(2) përcakton që, “[m]e kërkesë të një pale, ose *proprio motu*, pasi të ketë dëgjuar palët dhe kur është e zbatueshme, Mbrojtësin e Viktimave, për hir të një gjykimi të drejtë e të shpejtë, trupi gjykes mund të bëjë konstatim gjyqësor të fakteve të shqyrtuara në procese të tjera të Dhomave të Specializuara, ose në procedura përfundimtare të gjykatave të tjera në Kosovë, apo në sisteme gjyqësore të tjera që kanë lidhje me pika që kontestohen në procedurat aktuale, në qoftë se nuk kanë lidhje me veprimet dhe sjelljen e të akuzuarit që përmenden si akuza në aktakuzë.”

11. Gjithashtu, jurisprudenca përkatëse sugjeron se faktorët në vijim, ndër të tjerë, janë relevantë për ushtrimin e diskrecionit nga Trupi Gjykes gjatë marrjes së vendimit për të bërë konstatim gjyqësor të fakteve të propozuara, të shqyrtuara në procese të tjera: (i) faktet e propozuara janë të dallueshme, konkrete, dhe të identifikueshme; (ii) faktet e propozuara, siç janë formuluar nga pala parashtruese, nuk ndryshojnë në mënyrë të konsiderueshme nga formulimi i aktgjykimit origjinal; (iii) faktet e propozuara nuk janë të paqarta ose çorientuese në kontekstin e paraqitur në mocionin e palës parashtruese; (iv) faktet e propozuara nuk përmbajnë konstatime apo cilësime ligjore; (v) faktet e propozuara nuk bazohen në marrëveshje midis palëve në procesin origjinal; dhe

⁹ Kundërpërgjigjja e ZPS-së, para. 1. *Shih gjithashtu* Shtojcën 1 e Kundërpërgjigjes së ZPS-së.

¹⁰ Kundërpërgjigjja e ZPS-së, para. 17.

(vi) faktet e propozuara nuk janë në proces apeli apo rishikimi.¹¹ Gjatë ushtrimit të diskrecionit nëse duhet bërë konstatim gjyqësor i një fakti të propozuar, Trupi Gjykses në përgjithësi ka hedhur poshtë faktet që përbëjnë thelbin e argumenteve të Prokurorisë.¹² Faktet që janë të përgjithshme, të mjegullta, tendencioze, ose përmbajnë përfundime të pambështetura në prova gjithashtu janë hedhur poshtë.¹³ Trupi Gjykses mbajti parasysh gjithashtu edhe mundësinë që pala kundërshtare mund të kërkojë të paraqesë argumente për hedhjen poshtë të një fakti të propozuar, gjë që kushton kohë dhe burime dhe bëhet pengesë për arritjen e efikasitetit gjyqësor që synohet me rregullën 157(2).¹⁴

12. Trupi Gjykses vë në dukje se rregulla 157(2) e Rregullores synon arritjen e efikasitetit gjyqësor duke i dhënë Trupit Gjykses kompetenca diskrecionale për të bërë konstatim gjyqësor të fakteve të shqyrtuara në procese të tjera të Dhomave të

¹¹ *Shih p.sh.* ICTY, *Prosecutor v. Hadžihasanović and Kubura*, IT-01-47-T, Trial Chamber II, Decision on Judicial Notice of Adjudicated Facts Following the Motions Submitted by Counsel for the Accused Hadžihasanović and Kubura on 20 January 2005 ("[Hadžihasanović and Kubura Decision](#)"), 14 April 2005, p. 5; *Prosecutor v. Karadžić*, IT-95-5/18-T, Trial Chamber, Decision on Accused's Motion for Judicial Notice of Adjudicated Facts Related to Count One ("[Karadžić 21 January 2014 Decision](#)"), 21 January 2014, para. 6; *Prosecutor v. Popović et al.*, IT-05-88-T, Trial Chamber II, Decision on Prosecution Motion for Judicial Notice of Adjudicated Facts with Annex ("[Popović et al. Decision](#)"), 26 September 2006, paras 7-11, 14; *Prosecutor v. Blagojević and Jokić*, IT-02-60-T, Trial Chamber I, [Decision on Prosecution's Motion for Judicial Notice of Adjudicated Facts and Documentary Evidence](#), 19 December 2003, para. 16; *Prosecutor v. Prlić et al.*, IT-04-74-PT, Trial Chamber II, Decision on Motion for Judicial Notice of Adjudicated Facts Pursuant to Rule 94(b) ("[Prlić et al. Decision](#)"), 14 March 2006, para. 12; *Prosecutor v. Krajišnik*, IT-00-39-PT, Trial Chamber I, [Decision on Prosecution Motions for Judicial Notice of Adjudicated Facts and for Admission of Written Statements of Witnesses Pursuant to Rule 92 bis](#), 28 February 2003, para. 14; *Prosecutor v. Mladić*, IT-09-92, Appeals Chamber, Decision on Ratko Mladić's Appeal Against the Trial Chamber's Decisions on the Prosecution Motion for Judicial Notice of Adjudicated Facts ("[Mladić Decision](#)"), 12 November 2013, paras 92, 94. Trupi Gjykses vë në dukje se kriteri që faktet e propozuara të mos kenë të bëjnë me "veprimet dhe sjelljen" e të akuzuarve për të cilat janë ngritur akuzat në Aktakuzë nuk është faktor diskrecional, por parakusht për mundësinë e bërjes së konstatimit gjyqësor sipas rregullës 157(2) të Rregullores.

¹² *Shih* ICTY, *Prosecutor v. Stanišić and Župljanin*, IT-08-91-T, Trial Chamber II, Decision Granting in Part Prosecution's Motions for Judicial Notice of Adjudicated Facts Pursuant to Rule 94(B) ("[Stanišić and Župljanin Decision](#)"), 1 April 2010, para. 46; *Prosecutor v. Tolimir*, IT-05-88/2-A, Appeals Chamber, Judgement ("[Tolimir Appeal Judgment](#)"), 8 April 2015, paras 33-35. *Shih gjithashtu* *Prosecutor v. Karadžić*, IT-95-5/18-T, Trial Chamber, Decision on Accused's Motions for Reconsideration of Decisions on Judicial Notice of Adjudicated Facts ("[Karadžić 14 June 2010 Decision](#)"), 14 June 2010, para. 20.

¹³ *Shih gjithashtu* *Prosecutor v. Hadžić*, IT-04-75-T, Trial Chamber, Decision on Prosecution Motion for Judicial Notice of Adjudicated Facts and Documents ("[Hadžić Decision](#)"), 23 May 2013, para. 13.

¹⁴ *Shih p.sh.* ICTY, [Popović et al. Decision](#), para. 16; [Stanišić and Župljanin Decision](#), para. 45.

Specializuara, ose në procese të përfunduara në gjykata të tjera në Kosovë, apo sisteme gjyqësore të tjera lidhur me aspektet që po gjykohen në procesin aktual, duke e eliminuar ose zvogëluar kohën e nevojshme për paraqitjen e provave për faktet që janë vërtetuar më parë në procese të tjera.¹⁵ Me këtë, Trupi Gjykses duhet të garantojë në të njëjtën kohë edhe respektimin e të drejtave të të akuzuarve për gjykim të drejtë dhe të shpejtë, sikurse kërkohet sipas rregullës 157(2) të Rregullores.¹⁶

13. Duke bërë konstatim gjyqësor të fakteve të shqyrtuara në procese të tjera, Trupi Gjykses konfirmon prezumimin e bazuar mirë në lidhje me saktësinë e këtyre fakteve, të cilat rrjedhimisht nuk ka nevojë të provohen përsëri në gjykim.¹⁷ Meqë ky prezumim mund të kundërshtohet, çdo palë tjetër mund të paraqesë prova në gjykim që kundërshtojnë saktësinë e fakteve në fjalë. Trupi Gjykses e ka diskrecionin që të pranojë prova që plotësojnë ose konfirmojnë faktin për të cilin është bërë konstatim gjyqësor.¹⁸

IV. DISKUTIM

A. PARASHTRIMET E PALËVE

14. ZPS-ja parashtron se faktet e propozuara, të shqyrtuara në procese të tjera, (i) kanë të bëjnë me aspekte që po shqyrtohen në këtë proces;¹⁹ (ii) nuk kanë të bëjnë me veprimet dhe sjelljen e të akuzuarve për të cilat janë ngritur akuza në

¹⁵ KSC-BC-2020-05, F00191, Trial Panel I, Vendim mbi Konstatimin Gjyqësor të Fakteve të Shqyrtuara në Procese të Tjera ("Vendimi në Çështjen Mustafa"), 7 shtator 2021, para. 9. Shih gjithashtu [Karadžić 21 January 2014 Decision](#), para. 4; ICTR, *Prosecutor v. Bagosora et al.*, ICTR-98-41-A, Appeals Chamber, [Decision on Anatole Nsengiyumva's Motion for Judicial Notice](#), 29 October 2010, para. 10.

¹⁶ Vendimi në Çështjen Mustafa, para. 9. Shih gjithashtu [Mladić Decision](#), para. 24.

¹⁷ Shih p.sh. ICTY, *Prosecutor v. Perišić*, IT-04-81-PT, Trial Chamber I, [Decision on Prosecution's Motion for Judicial Notice of Facts Relevant to the Srebrenica Crime Base](#), 22 September 2008, para. 21; *Prosecutor v. Popović et al.*, IT-05-88-A, Appeals Chamber, [Judgement](#), 30 January 2015, para. 620; [Stanišić and Župljanin Decision](#), para. 25.

¹⁸ Shih p.sh. [Tolimir Appeal Judgment](#), para. 25-26.

¹⁹ Mocioni i ZPS-së, para. 3, 5-6.

Aktakuzën e Konfirmuar;²⁰ (iii) janë të dallueshme, konkrete dhe të identifikueshme;²¹ (iv) nuk ndryshojnë në mënyrë thelbësore nga formulimet në aktgjykimin origjinal;²² (v) nuk janë të paqarta ose çorientuese në kontekstin që janë parashtruar në Mocionin e ZPS-së;²³ (vi) nuk përmbajnë konstatime apo cilësime ligjore;²⁴ (vii) nuk bazohen në marrëveshje midis palëve në procesin origjinal;²⁵ dhe (viii) nuk janë në proces apeli apo rishikimi.²⁶ ZPS-ja gjithashtu pretendon se konstatimi gjyqësor i fakteve të propozuara, të shqyrtuara në procese të tjera, siguron balancën e duhur ndërmjet efikasitetit gjyqësor dhe të drejtës themelore të të akuzuarve për gjykim të drejtë, që do të ndihmojë efikasitetin gjyqësor dhe do të avancojë kryerjen e drejtë dhe të shpejtë të procesit.²⁷ ZPS-ja parashtron se synon të paraqesë prova për shumë nga aspektet e njëjta që kanë të bëjnë me faktet e propozuara, të shqyrtuara në procese të tjera, sepse: (i) ajo ka të drejtën që të kërkojë të paraqesë prova për t'i vërtetuar ato edhe nëse ekziston konstatim gjyqësor; dhe (ii) të njëjtat prova janë gjithashtu relevante për aspekte të tjera që diskutohen në këtë çështje.²⁸

15. Mbrojtja përgjigjet se koncepti i 'fakteve të shqyrtuara në procese të tjera' është koncept *sui generis*, që buroi në vendet ku zbatohet e drejta zakonore, ku përdorimi i tij kufizohet vetëm në çështje që nuk mund të kundërshtohen në mënyrë të arsyeshme, dhe pastaj "të shndërrohen në një lloj 'prezumimi faktik' që mund të kundërshtohet nga Mbrojtja".²⁹ Mbrojtja parashtron se faktet e shqyrtuara në procese të tjera duhet të mbesin "brenda kufijve të arsyeshëm që marrin parasysh rëndësinë e asaj që është e kontestueshme dhe që mbrojnë të drejtat e

²⁰ Mocioni i ZPS-së, para. 3, 7.

²¹ Mocioni i ZPS-së, para. 3, 8.

²² Mocioni i ZPS-së, para. 3, 9-10.

²³ Mocioni i ZPS-së, para. 3, 11.

²⁴ Mocioni i ZPS-së, para. 3, 12.

²⁵ Mocioni i ZPS-së, para. 3, 13.

²⁶ Mocioni i ZPS-së, para. 3, 14.

²⁷ Mocioni i ZPS-së, para. 3, 15.

²⁸ Mocioni i ZPS-së, para. 16.

²⁹ Përgjigjja e Përbashkët e Mbrojtjes, para. 2-3.

Mbrojtjes".³⁰ Mbrojtja pretendon se Trupit Gjykses i mbetet detyrimi që të sigurojë se pranimi i fakteve të caktuara që janë shqyrtuar në procese të tjera nuk cenon marrjen e vendimit të drejtë dhe të paanshëm në lidhje me akuzat në këtë çështje.³¹ Mbrojtja kundërshton edhe kategoritë konkrete të fakteve dhe faktet e përcaktuara në mënyrë individuale sepse janë: (i) fakte që kanë të bëjnë me veprimet dhe sjelljen e të akuzuarve;³² (ii) fakte bazë të kundërshtuara që kanë të bëjnë ose me ekzistencën e ndërmarrjes kriminale të përbashkët ose me sjelljen e vartësve në lidhje me incidente që kanë pasoja të drejtpërdrejta për përgjegjësinë penale të të akuzuarve;³³ (iii) fakte që nuk citojnë burime të identifikuar qartë të provave;³⁴ (iv) fakte të bazuara në prova që janë ose anonime ose që nuk janë nxjerrë në këtë çështje;³⁵ (v) fakte të bazuara në deklarata të të dyshuarve të cilët kurrë nuk kanë dëshmuar ose të cilët nuk mund të detyrohen të dëshmojnë, si dhe të dëshmitarëve që kanë vdekur;³⁶ (vi) fakte ku gjuha është kaq e mjegullt/e paqartë sa që nuk është e mundur të bazohesh në to pa iu referuar provave bazë, apo ku faktet janë 'përzgjedhur' nga konteksti burimor në një mënyrë që mjegullon ose shtrembëron konstatimet origjinale;³⁷ (vii) fakte që përbëjnë përshkrime të provave e jo konstatime konkrete;³⁸ (viii) fakte që kanë karakterizime juridike;³⁹ (ix) fakte që

³⁰ Përgjigjja e Përbashkët e Mbrojtjes, para. 3-4.

³¹ Përgjigjja e Përbashkët e Mbrojtjes, para. 6.

³² Përgjigjja e Përbashkët e Mbrojtjes, para. 7, 9-12. *Shih gjithashtu* Shtojcën 1 të Përgjigjes së Përbashkët të Mbrojtjes.

³³ Përgjigjja e Përbashkët e Mbrojtjes, para. 7, 13-14. *Shih gjithashtu* Shtojcën 1 të Përgjigjes së Përbashkët të Mbrojtjes.

³⁴ Përgjigjja e Përbashkët e Mbrojtjes, para. 7, 15-16. *Shih gjithashtu* Shtojcën 1 të Përgjigjes së Përbashkët të Mbrojtjes.

³⁵ Përgjigjja e Përbashkët e Mbrojtjes, para. 7, 17-21. *Shih gjithashtu* Shtojcën 1 të Përgjigjes së Përbashkët të Mbrojtjes.

³⁶ Përgjigjja e Përbashkët e Mbrojtjes, para. 7, 22-25. *Shih gjithashtu* Shtojcën 1 të Përgjigjes së Përbashkët të Mbrojtjes.

³⁷ Përgjigjja e Përbashkët e Mbrojtjes, para. 7, 26-27. *Shih gjithashtu* Shtojcën 1 të Përgjigjes së Përbashkët të Mbrojtjes.

³⁸ Përgjigjja e Përbashkët e Mbrojtjes, para. 7, 28. *Shih gjithashtu* Shtojcën 1 të Përgjigjes së Përbashkët të Mbrojtjes.

³⁹ Përgjigjja e Përbashkët e Mbrojtjes, para. 7, 29. *Shih gjithashtu* Shtojcën 1 të Përgjigjes së Përbashkët të Mbrojtjes.

nuk janë kundërshtuar në procesin origjinal;⁴⁰ dhe (x) fakte të bazuara në prova ose dëshmi të dëshmitarëve, të cilat ZPS-ja synon t'i paraqesë në këtë çështje.⁴¹

16. ZPS-ja përgjigjet se korniza ligjore e Dhomave të Specializuara ("DHS") pasqyron synimin që trupat gjykues të DHS-së duhet që, në interes të procesit të drejtë dhe të shpejtë, të kenë parasysh rezultatet e proceseve në TPNJ dhe në Kosovë në lidhje me krimet e kryera gjatë konfliktit në Kosovë, përfshirë provat e mbledhura dhe konstatimet faktike të bëra.⁴² ZPS-ja parashtron se: (i) përkufizimi tepër i gjerë i Mbrojtjes i "veprimeve dhe sjelljeve të të akuzuarve" nuk mbështetet në jurisprudencë;⁴³ (ii) rregulla 157(2) merret me fakte të vërtetuara, jo me prova;⁴⁴ (iii) me kundërshtimet e saj, Mbrojtja tenton të paraqesë kritere të reja të paarsyeshme;⁴⁵ (iv) faktet e propozuara, të shqyrtuara në procese të tjera, nuk janë rezultat i marrëveshjes midis palëve;⁴⁶ dhe (v) për faktet e propozuara, të shqyrtuara në procese të tjera, bazuar në prova të ZPS-së mund të bëhet konstatim gjyqësor.⁴⁷

B. ASPEKTE TË PËRGJITHSHME

17. Trupi Gjykues ka përcaktuar më lart dispozitat ligjore përkatëse dhe do të përvijojë shkurtimisht se si e ka zbatuar ligjin gjatë marrjes së vendimit mbi këtë kërkesë. Së pari, Trupi Gjykues kreu një analizë më vete të secilit fakt. Në rastet kur fakti i propozuar përmbante disa fjali dhe/ose propozime faktike, Trupi Gjykues shqyrtoi secilën prej tyre. Trupi Gjykues verifikoi nëse secili prej fakteve

⁴⁰ Përgjigjja e Përbashkët e Mbrojtjes, para. 7, 30-35. *Shih gjithashtu* Shtojcën 1 të Përgjigjes së Përbashkët të Mbrojtjes.

⁴¹ Përgjigjja e Përbashkët e Mbrojtjes, para. 7, 36-37. *Shih gjithashtu* Shtojcën 1 të Përgjigjes së Përbashkët të Mbrojtjes.

⁴² Kundërpërgjigjja e ZPS-së, para. 2-3.

⁴³ Kundërpërgjigjja e ZPS-së, para. 4.

⁴⁴ Kundërpërgjigjja e ZPS-së, para. 5-8. *Shih gjithashtu* Shtojcën 1 të Kundërpërgjigjes së ZPS-së.

⁴⁵ Kundërpërgjigjja e ZPS-së, para. 9-11.

⁴⁶ Kundërpërgjigjja e ZPS-së, para. 12-13.

⁴⁷ Kundërpërgjigjja e ZPS-së, para. 14-15.

të propozuara, të shqyrtuara në çështje të tjera i përmbushte kriteret e Rregullores dhe, në qoftë se po, nëse fakti në fjalë sidoqoftë duhej rrëzuar në bazë të diskrecionit të Trupit Gjykses. Në këtë kontekst, Trupi Gjykses ka marrë parasysh faktin se përgjegjësinë e vërtetimit për përmbushjen e kriterëve të Rregullores e ka pala që parashtron kërkesën.⁴⁸

18. Gjatë ushtrimit të diskrecionit, Trupi Gjykses ka marrë parasysh një numër faktorësh, përfshirë faktorët në vijim. Së pari, Trupi Gjykses hodhi poshtë faktet që nuk kishin lidhje të qartë dhe të vërtetueshme me pikat që kontestohen në procesin aktual. Trupi Gjykses gjithashtu refuzoi të bënte konstatim gjyqësor të një numri faktesh të propozuara, të shqyrtuara në procese të tjera, që ishin të mjegullta, të paqarta, tepër të përgjithshme ose u mungonte konteksti ose konkretësia e mjaftueshme faktike për të ndihmuar Trupin Gjykses në përmbushjen e përgjegjësiave për konstatimin e fakteve. Trupi Gjykses gjithashtu pranoi riformulime të vogla të fakteve të propozuara, të shqyrtuara në procese të tjera, të sugjeruara nga ZPS-ja, kur riformulimi e bën faktin e propozuar, të shqyrtuar në procese të tjera, më të kuptueshëm dhe shmang shtrembërimin e konstatimit origjinal.⁴⁹ Trupi Gjykses gjithashtu ka ushtruar diskrecionin që të mos bëjë konstatim të fakteve të propozuara, të shqyrtuara në procese të tjera, e që kanë shumë pak relevancë për çështjen në fjalë.

C. VLERËSIMI I FAKTEVE TË PROPOZUARA, TË SHQYRTUARA NË PROCESË TË TJERA

19. Së pari, Trupi Gjykses është bindur se të gjitha faktet e propozuara, të shqyrtuara në procese të tjera, burojnë nga proceset e Dhomave të Specializuara

⁴⁸ *Shih* ICTY, [Popović et al. Decision](#), para. 21; *Prosecutor v. Milosević*, IT-98-29/1-T, Trial Chamber III, [Decision on Prosecution's Motion for Judicial Notice of Adjudicated Facts and Prosecution's Catalogue of Agreed Facts with Dissenting Opinion of Judge Harhoff](#), 10 April 2007, para. 29; *Prosecutor v. Popović et al.*, IT-05-88-T, Trial Chamber, Judgement and Sentence, 10 June 2010, para. 1611; [Tolimir Appeal Judgment](#), para. 24.

⁴⁹ *Shih p.sh.* Shtojcat 1-2 të këtij Vendimi, fakti 298 i shqyrtuar në procese të tjera, ku "para marsit 1998" ka zëvendësuar formulimin "periudha e Aktakuzës" në konstatimin origjinal.

ose procese të përfunduara në gjykata të tjera të Kosovës, ose juridiksione të tjera.

20. Pas shqyrtimit individual të secilit prej fakteve të propozuara të shqyrtuara në procese të tjera, Trupi Gjykses vë në dukje se ZPS-ja nuk ka vërtetuar se faktet e propozuara 33, 35, 37-38, 40, 92-93, 102-109, 152, 157-158, 170, 174, 253-255, 271, dhe 276, të shqyrtuara në procese të tjera, kanë të bëjnë me aspekte që po gjykohen në këtë proces. Për këtë arsye, Trupi Gjykses prandaj të bëjë konstatim gjyqësor të këtyre fakteve të propozuara, të shqyrtuara në procese të tjera.

21. Trupi Gjykses gjithashtu vë në dukje se faktet e propozuara 115, 248, 265, 270, 274, të shqyrtuara në procese të tjera, nuk kanë qartësi, kontekst dhe konkretësi të mjaftueshme. Trupi Gjykses konstaton se këto fakte të propozuara, të shqyrtuara në procese të tjera, nuk e ndihmojnë Trupin Gjykses në përmbushjen e funksionit të konstatimit të fakteve. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses ushtron diskrecionin që të mos bëjë konstatim gjyqësor të këtyre fakteve të propozuara, të shqyrtuara në procese të tjera.

22. Trupi Gjykses vë në dukje se fakti i propozuar 366, i shqyrtuar në procese të tjera, thjesht ritregon pjesë të dëshmisë së dhënë nga një dëshmitar në Çështjen e TPNJ-së *Haradinaj dhe të tjerët*. Trupi Gjykses konstaton se fakti i propozuar 366, i shqyrtuar në procese të tjera, nuk përmban konstatime dhe, rrjedhimisht, ai refuzon të bëjë konstatim gjyqësor të tij. Trupi Gjykses gjithashtu vë në dukje se fakti i propozuar 299, i shqyrtuar në procese të tjera, thjesht përsërit fjalinë e fundit të faktit të propozuar 298, të shqyrtuar në procese të tjera. Për këtë arsye, Trupi Gjykses refuzon të bëjë konstatim gjyqësor për faktin e propozuar 299, të shqyrtuar në procese të tjera. Trupi Gjykses vë në dukje se fakti i propozuar 105, i shqyrtuar në procese të tjera, ndryshon në thelb nga formulimi në aktgjykimet origjinale dhe, sido që të jetë, ka shumë pak relevancë. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses refuzon të bëjë konstatim gjyqësor të tij. Trupi Gjykses gjithashtu vë në dukje se ZPS-ja tërhoqi kërkesën për konstatim gjyqësor të fakteve të propozuara

608-610 të shqyrtuara në procese të tjera.⁵⁰ Rrjedhimisht, Trupi Gjykses refuzon të bëjë konstatim gjyqësor të fakteve të propozuara 608-610 të shqyrtuara në procese të tjera.

23. Gjatë ushtrimit të diskrecionit për të bërë konstatim gjyqësor të fakteve të propozuara, të shqyrtuara në procese të tjera, Trupi Gjykses ka riformuluar *proprio motu* faktet e propozuara 6, 24, 67, 71, 173, 246, 260, 275, dhe 300 të shqyrtuara në procese të tjera, në mënyrë që ato të përputhen më shumë me konstatimet origjinale. Gjithashtu, Trupi Gjykses ka riformuluar faktet e propozuara 52-55 të shqyrtuara në procese të tjera, në mënyrë që të jenë qartësisht të identifikueshme dhe të bëhet e qartë koha përkatëse. Trupi Gjykses gjithashtu ka riformuluar faktet e propozuara 200, 420, 498, dhe 618 të shqyrtuara në procese të tjera, në përputhje me Njoftimin e ZPS-së.

24. Trupi Gjykses gjykon se faktet e propozuara 1-32, 34, 36, 39, 41-91, 94-101, 110-114, 116-151, 153-156, 159-169, 171-173, 175-247, 249-252, 256-264, 266-269, 272-273, 275, 277-298, 300-365, 367-607, dhe 611-734, të shqyrtuara në procese të tjera, përmbushin kriteret e rregullës 157(2) për aq sa nuk kanë të bëjnë me veprimet dhe sjelljet e të akuzuarve të paraqitura në Aktakuzë. Në këtë aspekt, Trupi Gjykses vë në dukje se, në kundërshtim me parashtrimet e Mbrojtjes në lidhje me faktet e propozuara 460 dhe 461⁵¹ të shqyrtuara në procese të tjera, TPNJ-ja dhe TPNR-ja konstatuan se ndalimi kategorik i konstatimit gjyqësor të fakteve që kanë të bëjnë me veprimet dhe sjelljen e të akuzuarve nuk vlen, për shembull, për veprimet dhe sjelljen e kryesve fizikë ose ekzistencën dhe aktivitetin e një ndërmarrjeje kriminale të përbashkët ose të anëtarëve të saj (përveç të akuzuarve).⁵²

⁵⁰ Njoftimi i ZPS-së, para. 1.

⁵¹ Përgjigjja e Përbashkët e Mbrojtjes, para. 7, 9-12. *Shih gjithashtu* Shtojcën 1 e Përgjigjes së Përbashkët të Mbrojtjes.

⁵² ICTR, *Prosecutor v. Karemera*, ICTR-98-44-AR73(C), Appeals Chamber, [Decision on Prosecutor's Interlocutory Appeal of Decision on Judicial Notice](#), 16 June 2006, paras 48-53. *Shih gjithashtu* ICTY, [Popović et al. Decision](#), para. 13; [Mladić Decision](#), paras 82-87.

25. Trupi Gjykses gjithashtu është i mendimi se faktet e propozuara 1-32, 34, 36, 39, 41-91, 94-101, 110-114, 116-151, 153-156, 159-169, 171-173, 175-247, 249-252, 256-264, 266-269, 272-273, 275, 277-298, 300-365, 367-607, dhe 611-734 të shqyrtuara në procese të tjera: (i) janë të dallueshme, konkrete dhe të identifikueshme; (ii) nuk ndryshojnë në mënyrë të konsiderueshme nga formulimi i aktgjykimit origjinal; (iii) nuk janë të paqarta ose çorientuese në kontekstin e paraqitur në mocionin e palës parashtruese; (iv) nuk përmbajnë konstatime apo cilësime ligjore; (v) nuk bazohen në marrëveshje midis palëve në procesin origjinal; dhe (vi) nuk janë në proces apeli apo rishikimi. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses është bindur se për këto fakte të propozuara, të shqyrtuara në procese të tjera, duhet të ketë konstatim gjyqësor.

26. Trupi Gjykses thekson se konstatimi gjyqësor i fakteve të shqyrtuara në procese të tjera, krijon prezumim të kundërshtueshëm të saktësisë së këtyre fakteve. Kjo nuk ndikon në të drejtën dhe aftësinë e Mbrojtjes për të kundërshtuar çfarëdo pretendimi faktik që është pjesë e argumenteve të Prokurorisë, apo çfarëdo fakti për të cilin është bërë konstatim gjyqësor nga Trupi Gjykses. Gjithashtu, fakti që Trupi Gjykses ka bërë konstatim gjyqësor të një fakti të shqyrtuar në procese të tjera nuk eliminon detyrimin që ka ZPS-ja për të provuar jashtë dyshimit të arsyeshëm faktet materiale që janë relevante për argumentet e veta. Është e rëndësishme që Trupit Gjykses t'i jepen të gjitha provat relevante në lidhje me këto fakte për t'i mundësuar të kryejë funksionet e tij për gjykimin e fakteve, në veçanti në lidhje me faktet për të cilat palët nuk pajtohen.

V. VENDIM

27. Për arsyet e lartpërmendura, Trupi Gjykses:

- a) **MIRATON** mocionin e ZPS-së, pjesërisht;
- b) **BËN KONSTATIM GJYQËSOR** të këtyre fakteve të propozuara, të shqyrtuara në procese të tjera, sikurse paraqiten në Shtojcën 1 të këtij

